VENDIM
Nr.226, datë 23.3.2011

PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR.66, DATË 7.2.2011 TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE "PËR NJË SHTESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË E BRENDSHME, PËR BLERJE PAJISJESH, MJETESH DHE MATERIALESH SPECIALE, NË PLOTËSIM TË NEVOJAVE TË POLICISË SË SHTETIT DHE TË GARDËS SË REPUBLIKËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë" dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 "Për buxhetin e vitit 2011", me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në vendimin nr.66, datë 7.2.2011 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto ndryshime:

1. Në titullin e vendimit fjalët "... dhe të Gardës së Republikës ..." shfuqizohen.

2. Pika 1 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"1. Ministrisë së Brendshme, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, në programin buxhetor "Policia e Shtetit", t'i shtohet fondi prej 660 000 000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë milionë) lekësh, për blerje pajisjesh, mjetesh, materialesh të tjera speciale, si dhe për sistemin e monitorimit me kamera të qytetit të Tiranës.

Nga ky fond, 634 650 700 (gjashtëqind e tridhjetë e katër milionë e gjashtëqind e pesëdhjetë mijë e shtatëqind) lekë të klasifikohen, si shpenzime për investime, dhe 25 349 300 (njëzet e pesë milionë e treqind e dyzet e nëntë mijë e treqind) lekë, për mallra e shërbime.".

3. Pika 2 ndryshohet, si më poshtë vijon:

"2. Fondi, prej 660 000 000 (gjashtëqind e gjashtëdhjetë milionë) lekësh, të përballohet nga
fondi rezervë i Këshillit të Ministrave.".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha